

VENDIM
Nr. 860, datë 4.12.2012

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 916, DATË 29.12.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE NË KOMUNËN VËRTOP TË QARKUT TË BERATIT” DHE PËR NJË NDRYSHIM
NË VENDIMIN NR. 417, DATË 8.4.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E
LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE PYJE DHE KULLOTA QË DO TË TRANSFEROHEN
NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE, KOMUNA VËRTOP TË QARKUT TË
BERATIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të neneve 2, 3 dhe 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar dhe të nenit 23 të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së ndryshuar të inventarit të pronave të paluajtshme të tipit pyje dhe kullota, në territorin administrativ të komunës Vërtop.

Lista është me 20 (njëzet) fletë, fillon me numër rendor 171 dhe mbaron me numër 632.

2. Miratimin e listës së ndryshuar të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të kësaj njësie.

Lista ka 12 (dymbëdhjetë) fletë dhe mbaron me numër rendor 267.

3. Listat me ndryshimet në inventar dhe ndryshimet në listën e pyjeve/kullotave që transferohen në pronësi dhe lidhja numër 1, i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

4. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Vërtop e qarkut të Beratit, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha